



C.nr.464/10

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ , Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil ,gjyqtari Burim Emërllahu , në çështjen kontestuese të [REDACTED] , nga Ferizaji ,rr' [REDACTED] , kundër të paditurit [REDACTED] ,nga [REDACTED] Republika e Serbisë, të cilin e përfaqëson [REDACTED] ,avokat nga Shtërpca ,baza juridike vërtetimi i pronësisë, me datën 30.10.2017 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaji, dhe vërtetohet se paditësi [REDACTED] nga Ferizaji është pronarë i ngastrës kadastrale 00706-1,Zona Kadastrale Bablak,në sipërfaqe prej 1424 m2.

A r s y e t i m

Paditësi [REDACTED] nga Ferizaji, ka parashtruar padi në këtë Gjykatë ,kundër të paditurit [REDACTED] nga [REDACTED] Republika e Serbisë, me bazë juridike vërtetimi i pronësisë.

Paditësi gjatë shqyrtimit kryesorë ka theksuar: palujtëshmërin kontestuese e kamë blerë nga [REDACTED] , në vitin 1988 me qmim për 100 marka ari, të cilën shumë ia kam paguar në tërësi [REDACTED] , kurse [REDACTED] , tokën kontestuese ma ka dorëzuar në posedim , kurse unë e posedoj nga viti 1988 e deri tani 2017, pa u penguar nga askush, as nga serbët e as nga shqipëtarët. Kurse [REDACTED] alujtshmërin kontestuese e ka blerë më herët nga [REDACTED] babi i [REDACTED] Unë këtë paluejtshmëri e kamë shfrytëzuar në atë mënyrë që e kam mbjellur grurë ,kallamoq, bari, kurse në kohën e fundit kam mbjellur pemë molla kumbulla.

Paditësi ka kërkuar nga gjykata që të vërtetohet se paditësi [REDACTED] është pronarë i ngastrës kadastrale nr. 00706-1,në sipërfaqe prej 1424 m2 Zona Kadastrale Bablak.

Përfaqësuesi i të paditurit av [REDACTED] nga Shtërpca ka theksuar: e pranoj kërkesë padinë e paditësit për atë se i padituri me autorizim me të cilin më autorizon që ta përfaqësoj thekson që e pranoj kërkesë padinë. Ky fakt sot, me dëshmitarët e dëgjuar vërtetohet se paditësi [REDACTED], ngastrën e përmendur kadastrale e ka blerë nga [REDACTED], kurse [REDACTED] atë ngastër e ka blerë nga [REDACTED] dhe atë para vitit 1988. Pasi dëshmitarët e dëgjuar e vërtetojnë faktin se paditësi nga dita e blerjes e deri më tani nuk është penguar nga askush në posedimin dhe mbajtjen e ngastrës së përmendur, sot e pranoj kërkesëpadinë e paditësit, dhe pajtohem se ngastra e përmendur, me aktgjykim gjyqësor të bartet në paditësin [REDACTED].

Me qëllim të vlerësimit sa më të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë qështje civilo juridike janë administruara si provë: çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme e datës 07.06.2017, me nr.56669-2017e lëshuar nga Zona Kadastrale Komunale Ferizaj, në emër të [REDACTED], mendimi dhe konstatimi i ekspertës gjeodete [REDACTED], njoftimi i lëshuar nga Agjensia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës, si dhe janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarve : [REDACTED] dhe [REDACTED], nga Fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajit, si dhe është dëgjuar në cilësi të palës paditësi [REDACTED].

Gjykata i ka vlerësuar provat sipas neni 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertës gjeodete [REDACTED] të cilin ia ka prezantuar me shkrim edhe çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme të datës 07.06.2017, gjykata ka vërtetuar se paluajtshmëria kontestuese, konkretisht ngastrat kadastrale 00706-1 Zona Kadastrale Bablak në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Ferizaj, evidentohen në emër të paditurit [REDACTED] dhe ka sipërfaqe prej 1424 m².

Nga deklaratat e dëshmitarëve [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, deklarata e paditësit [REDACTED] në cilësin e palës gjykata ka vërtetuar se paditësi [REDACTED] paluajtshmerin kontestuese e ka blerë nga [REDACTED], në vitin 1988 për qmimin prej 100 marka për ari, të cilin qmim paditësi ia ka paguar në tërësi [REDACTED] kurse [REDACTED] [REDACTED] ka dorëzuar në posedim paluejtshmerin kontestuese, kurse [REDACTED] [REDACTED] e posedon paluejtshmerin kontestuese nga viti 1988 e deri tani 2017, pa u penguar nga askush, në atë mënyrë që ka bërë kultivimin e kulturave bujqësore.



Nga deklarata e dëshmitarit [REDACTED], gjykata ka vërtetuar se tokën kontestuese [REDACTED], e ka blerë nga [REDACTED] q para vitit 1988, të cilit [REDACTED] ia ka paguar në tërësi qmimin e shitblerjes së paluejtshmërisë kontestuese, kurse faktin se [REDACTED] paluejtshmërin kontestuese e ka blerë nga [REDACTED], gjykata e ka vërtetuar edhe me dëgjimin e paditësit në cilësi të palës.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe të shpjeguar si në arsyetimit të këtij aktgjykimi, ka vendosur si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar edhe në dhe dispoziten e neni 28 të Ligjit për Mardhëniet Themelore Pronësore Juridike, si dhe nenin 40 të Ligjit Për Pronësin dhe të Drejtat Tjera Sendore, kuptohet për periudhën kohore në të cilën është në fuqi ky ligj .

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Më datë :30.10.2017

Gjyqtari



Burim Emërllahu

[Handwritten signature]

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.





Nga deklarata e dëshmitarit [REDACTED] gjykata ka vërtetuar se tokën kontestuese [REDACTED] ka blerë nga [REDACTED] para vitit 1988, të cilit [REDACTED] ka paguar në tërësi qmimin e shitblerjes së paluejtshmërisë kontestuese, kurse faktin se [REDACTED] paluejtshmërin kontestuese e ka blerë nga [REDACTED] gjykata e ka vërtetuar edhe me dëgjimin e paditësit në cilësi të palës.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe të shpjeguar si në arsyetimit të këtij aktgjykimi, ka vendosur si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar edhe në dhe dispoziten e neni 28 të Ligjit për Mardhëniet Themelore Pronësore Juridike, si dhe nenin 40 të Ligjit Për Pronësin dhe të Drejtat Tjera Sendore, kuptohet për periudhën kohore në të cilën është në fuqi ky ligj .

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Më datë :30.10.2017

Gjyqtari

Burim Emërllahu



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.

